

KU HYN MARIA, NUK HYN MJEKU

**A DUHET BESUAR NË VETITË
ÇUDIBËRËSE TË MASAZHEVE DHE
ÇLIRIMIT TË ENERGJISË NEGATIVE
QË NDODH GJATË TYRE? PO, POR
VETËM NËSE TAKONI FIZIOTERAPISTIN
E DUHUR. NE PATËM FAT: GJETËM
MARIAN, FIZIOTERAPISTE DHE ESTETISTE
TE "JOYEL SPA", DHE ZBULUAM ÇUDI
QË NUK MUND TË SHPJEGOHEN ME
FJALË, POR VETËM ME MASAZH**

Elda Laze

Vetëm origjina filipinase apo tajlandeze nuk mjafton për të besuar verbërisht në mrekullinë e masazheve që ofrojnë SPA-të në Tiranë. Vendet e Azisë Lindore njihen botërisht për kulturën mijëra vjeçare në këtë fushë, por jo domosdoshmërisht të gjithë njerëzit atje e kanë të trashëguar dhuntinë e fizioterapisë. E armatosur mirë me këtë lloj skepticizmi, nisem të takoj Maria Cristina Decampos, fizioterapiste dhe terapiste bukurie te "Joyel SPA", një prej SPA-ve më me emër në Tiranë. Maria propozon të më bëjë një vizitë refleksologjike. "Refleksologjia është një mjekësi alternative, e cila nëpërmjet ekzaminimit të zonave të caktuara të shpirtave të këmbës që i korrespondojnë organeve dhe pjesëve të ndryshme të organizimit, identifikon gjendjen e përgjithshme të organizimit", shpjegon, ndërkohë që ka filluar punën me mua. Më fërkon shpirtin e këmbës duke qëndruar pak më gjatë në zona të caktuara. "Nëpërmjet një ekzaminimi të fillit, Maria ka arritur të zbulojë sëmundje vërtet serioze që kanë të bëjnë me organet të brendshme. Një kliente pati fat që e ndoqi këshillën e Marias. Brenda muajit u operua dhe po të mos kishte qenë Maria, ajo nuk do të kishte shkuar fare te mjeku e ndoshta do të kishte qenë shumë vonë edhe për operacion", thotë Majlinda, administratore e "Joyel SPA".

Problemet e mia lidheshin vetëm me stresin dhe qëndrimin e zgjatur para kompjuterit. "Stresi është burim kryesor i të gjitha sëmundjeve dhe lodhjeve të njeriut. Për këtë arsye janë hapur SPA-të, një industri gjithnjë e në rritje, që u dedikohen relaksit, qetësisë dhe trajtimeve antistres", thotë Maria, e cila krahas masazheve të trupit, te "Joyel" trajton edhe masazhet e fytyrës. "Kur lodhja është aq e madhe sa nuk ta mbajnë as shpatullat, stresi fillon e të vizatohet në fytyrë. Lëkura e fytyrës është një pasqyrim i gjendjes së brendshme së organizimit. Unë e kuptoj që në pamje të parë se për çfarë ka nevojë një klient. Një avantazh tjetër që lehtëson punën time te "Joyel" është se këtu përdoren vetëm produkte



të Gernetic, që janë lider në kujdesin e lëkurës prej më shumë se 31 vjetësh. Gernetic është një linjë tërësisht bimore dhe tepër e avancuar. Pjesa më e madhe e SPA-ve jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, ofrojnë masazhet klasike relaksuese, banjat dhe trajtime të ndryshme (siç janë me alga, kakao, rush), që në fakt, përveçse janë relaksuese, nuk kanë ndonjë efekt terapeutik. Kurse produktet e Gernetic trajtojnë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, që shkaktojnë probleme në lëkurë", thotë Maria dhe duart e saj brenda disa minutash sikur më thithën gjithë stresin, rraskapitjen dhe energjinë negative të mbledhur brenda kushedi prej sa kohësh. "Gjatë masazhit bëhet shkëmbimi i energjisë (mes asaj pozitive dhe negative). Ankthi, stresi, depresioni, lodhja janë manifestim i energjisë negative. Nëpërmjet masazheve të ndryshme, klientët e shkëmbejnë këtë energji". Këtë energji e merr masazhatori? "Masazhatori dinë ta shkarkojnë menjëherë energjinë negative që marrin duke krijuar sërisht një balancë. Kështu që mos u shqetëso për mua", qesh Maria duke i dhënë fund jo vetëm masazhit, por edhe dyshimeve se mund të kisha takuar një tjetër filipinase që, përveç origjinës, asgjë nuk do ta lidhte me fizioterapinë. Në fakt, a janë të gjitha filipinaset po kaq profesioniste si Maria? "Jo. Të lindësh në Filipine nuk do të thotë që ke lindur masazhator. Sigurisht, jemi një vend që e kemi traditë dhe kulturë, por kjo nuk ka të bëjë me profesionin dhe dhuntinë. E para është dhuntia që unë e kam pasur ndoshta qëkur kam lindur. Mbaj mend që gjyshja më thoshte: "Me këto duar ti mund të bësh mrekullitë". Maria bën vërtet mrekullitë të atilla që nuk mund të shpjegohen siç duhet me fjalë. Më mirë me një masazh!

JOYEL SPA & BEAUTY CENTER ATY KU NIS NJË JETË E RE

Tirana ka hyrë në vorbullën e shpejtë të jetës frenetike metropolitane dhe po vuan pasojat e saj: stresin, depresionin, ankthin, frikën për të ardhmen. Ekziston vetëm një vend i pakohë ku relaksi, qetësia, duket sikur të çojnë në vise të largëta. Jemi të lumtur t'ju prezantojmë me "Joyel, SPA & qendër estetike", ku gjithçka i shërben shëndetit të trupit dhe mendjes. I ndërtuar në vitin 2007 nga lidhja e fortë e miqësisë mes dy mikeshash të ngushta, "Joyel" nuk ka sesi të mos jetë një vend miqësor dhe mikpritës. Ndjesia e qetësisë dhe çlirimit të energjive negative nis me të kapërcyer pragun. Të duket sikur hyn në një pjesë të shkëputur nga Tirana.

Muzika New Age në sfond, e kombinuar me gurgullimën e ujit që dëgjohet nga përrenj artificialë të instaluar në dysheme, me statuja të Budës e me dhjetëra detaje Feng Shui në dizajnin e brendshëm, krijojnë shkëputjen me realitetin e zhurmshëm të kryeqytetit.

E konceptuar nga një arkitekt kinez i specializuar në ndërtimin e SPA-ve, "Joyel" ofron hapësirën, luksin dhe rehatinë e të ndjerit në shtëpi. Stafi përbëhet nga 6 fizioterapistë e estetistë filipinas, të specializuar në universitetet më të mira në Filipine dhe të diplomuar në Francë. Të kujdesshëm ndaj kërkesave të klientëve, estetistët përdorin gjithnjë formula të ndryshme kremrash e trajtimeve për fytyrën dhe trupin. Një veçori e "Joyel-it" është se këtu banjat turke shoqërohen me scrub trupi, të formuluar nga receta popullore filipinase, që ndryshojnë çdo ditë e askush tjetër veç stafit nuk di t'i zbërthejë. Njëkohësisht, duke përdorur produkte të Gernetic, që vijnë drejtpërsëdrejti nga Laboratorët Ndërkombëtare të Gernetic në Francë, "Joyel-i" është shndërruar në lider dhe në shembullin më pozitiv të ndërtimit të një SPA-je në Shqipëri. Duke çliruar peshën e rëndë të një të përditshmeje plot stres e duke u zhytur në një botë relaksi dhe rinovimi, te "Joyel" duket sikur jeta nis nga e para.



"Joyel" ju mirëpret në adresën:
"Rruga e Elbasanit", pallati i verdhë përballë diskos "Calvin", kati II
Tel/Faks: 00355 4234 79 79 Cel: 00355 672032542
E-mail: info@joyelspa.com Web: www.joyelspa.com
(Parkimi te disko "Calvin")